



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1458/2022

Datë: 23 nëntor 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me datë 23 nëntor 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që menjëherë të anulojë vendimin Nr.03/109 të datës 23 nëntor 2022.
- II. Puna e prokurorive reduktohet dhe do të vazhdojë vetëm me shërbime esenciale.
- III. Lista e shërbimeve esenciale do të miratohet në takimin e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- IV. Këshilli dhe prokuroritë pezullojnë të gjitha format e bashkëpunimit me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- V. Në qoftë se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk shfuqizon vendimin e lartcekur deri me datë 08 dhjetor 2022, Këshilli do të vendos për masa të tjera.
- VI. Njoftohen të gjithë partnerët ndërkombëtarë me këtë vendim.
- VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Kryeministrit të R. Kosovës;
- Prokurorëve të prokurorive;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.